



Pranuar / Dorëzuar Priljeho/Prodato Received/Delivery	27-06-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	4979	2023	1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.754/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ardit Perçuku Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.754/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesja _____ nga Ferizaj, kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 27.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.754/2023 e datës 18.05.2023, e parashtruar nga ankuesja _____
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.01-58/23 i datës 18.04.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Komunën e Ferizajt.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ (tutje vetëm ankuesja) më datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.01-58/23 të datës 18.04.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Komunën e Ferizajt, me pretendimet ankimore së e procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Ferizajt është zhvilluar me një numër të madh parregullsisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje ne ankesë në Komunën e Ferizajt, ndërsa kjo e fundit më datë 26.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4327/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankueses të datës 13.04.2023 e parashtruar tek Komisioni për Vlerësim Brenda Kategorisë; Vendimin me Nr.01-58/23 të datës 18.04.2023 të Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 20.03.2023 nga Menaxherja e Personelit për ankuesen; Njoftimin e datës 04.04.2023 të Menaxheres së Personelit lidhur me njoftimin e mbajtjes së intervistës me gojë; Formularin për kërkesë apo ankesë me numër 01-111/01-0033442/23 të datës 13.04.2023 e parashtruar nga ankuesja; E-mailin zyrtar të datës 18.04.2023 nga Menaxherja e Personelit lidhur me dërgimin e vendimit të KVLB-së për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.05.2023 nga Komuna e Ferizajt së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Listën e ngushtë të aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Shkresën zyrtare të datës 28.03.2023 nga Menaxherja e Personelit lidhur me hartimin e listës së ngushtë; Njoftimin me Nr.01-59/23 të datës 18.04.2023 nga Zyra e Burimeve Njerëzore për kandidatin e suksesshëm pas afatit të ankesave; Njoftimin me Nr.01-55/23 të datës 07.04.2023 nga Zyra e Burimeve Njerëzore për kandidatin e suksesshëm; Njoftimin e datës 04.04.2023 përmes e-mailit zyrtar nga Menaxherja e Personelit për ankuesen lidhur me mbajtjen e intervistës me gojë; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Formularët e intervistës me gojë për kandidaten e përzgjedhur A.R të datës 07.04.2023 nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit; Formularët e intervistës me gojë për ankuesen D.A të datës 07.04.2023 nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ të datës 07.04.2023; Kopjen e letërnjoftimit të kandidates A.R; Aplikacionin e kandidates A.R të datës 15.12.2022 së bashku me dëshmitë e bashkangjitura si në vijim dhe atë: Diplomën me Nr.1582 të datës 24.12.2020 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik në Prishtinë; Certifikatën me Nr.11167/675 të datës 27.02.2012 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik; Shkresën zyrtare me numër LRP.Nr.14141/2022 nga noteri S.SH; Certifikatën e licencimit me numër 340/19 R të datës 12.11.2019 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Vendimin me Nr.219/2015 të datës 01.07.2015 nga Menaxheri i Personelit në Komunën e Ferizajt; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.11.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 29.01.2021; Certifikatën nga IMCRJ; Certifikatën nga Iksad Global të datës 04.06.2022; Certifikatën nga Ispek Maku për periudhën nga 19-20.03.2022; Akt emërimit të datës 23.01.2013; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 11.06.2019; Vendimin 01.Nr.01-67/21 të datës 15.12.2021; Vërtetimin e datës 01.11.2022; Aplikacionin e ankueses të datës 16.12.2022 së bashku me dëshmitë e bashkangjitura si në vijim dhe atë: Vërtetimin e datës 16.12.2022 nga Menaxherja e Personelit; Akt emërimit të datës 01.07.2011; Certifikatën e licencimit me numër 673/20 të datës 11.01.2021 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Vendimin me Nr.02-131/03-0114161/21 të datës 01.10.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.02.2021; Vendimin me numër Ref.6/710 të datës 03.02.2012 nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT; Kopjen e konkursit të datës 23.11.2022 me numër të referencës RN00010474; Vendimin me Nr.01-199/22 të datës 20.1.2022 të NJBNJ-së; Vendimin për themelimin e komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë me Nr.01-199/22 të datës 14.12.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 11.06.2019 për E.S; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 10.09.2018 për F.V; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 01.02.2018 për I.A; Akt emërimit të datës 01.07.2011 për B.M si dhe Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të datës 25.11.2019 për S.B-B; E-maili i datës 26.06.2023 nga Udhëheqësja e BNJ për KPMSHCK-në; Vërtetimi me numër protokolli 11 i datës 26.06.2023 i Udhëheqësit të Divizionit për

Mbështetje Administrative të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë si dhe E-maili zyrtar i datës 27.06.2023 nga Udhëheqësi i Divizionit për Mbështetje Administrative të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë për KPMSHCK-në.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Komuna e Ferizajt, më datë 23.11.2022 ka publikuar në SIMBNJ, Konkursin me numër reference RN00010474 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës *Drejtor i Qendrës për Punë Sociale, klasa Drejtues i Ulët 1*. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 08.12.2022 deri 16.12.2022, e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesja.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se fillimisht me datë 20.12.2022 Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt me Vendimin Nr.01-199/2022 ka refuzuar aplikacionin e ankueses, me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës, mirëpo pas Vendimit të Këshillit A.nr.166/2023 të datës 07.03.2023, ankuesja është përshirë në listën e ngushtë duke marrë pjesë në të gjitha fazat e kësaj procedure.

Bazuar në vlerësimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë (tutje Komisioni i Vlerësimit) i themeluar sipas Vendimit Nr.01-199/22 të datës 14.12.2022, ankuesja është vlerësuar me gjithsej 88.6 pikë, duke u renditur si kandidatja e dytë, kurse sipas Njoftimit Nr.01-55/23 të datës 07.04.2023 të Zyrës së Burimeve Njerëzore, kandidatja e suksesshme e cila ka arritur të grumbulloj pikë më së shumti lidhur me pozitën e punës *Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*, në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Ferizajt është shpallur kandidatja .
i me gjithsejtë 94 pikë të grumbulluara.

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit, më datë 13.04.2023 ka parashtruar ankesë pranë këtij Komisioni, ndërsa ky i fundit me Vendimin Nr.01-58/23 të datës 18.04.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses dhe ka lënë në fuqi Njoftimin me Nr.01-55/23 të datës 07.04.2023 për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesja brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.01-58/23 të datës 18.04.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Komunën e Ferizajt, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit për pozitën *Drejtor i Qendrës për Punë Sociale* në Komunën e Ferizajt është zhvilluar me një numër të madh parregullsish duke filluar nga ajo lidhur me ndryshimin e vendit për zhvillimin e intervistës verbale, ka pasur shkelje dhe pabarazi lidhur me përfaqësimin nga ana e anëtarëve të komisionit nga drejtori të ndryshme, një anëtare e komisionit ka pasur lidhje me kandidaten e cila edhe është përzgjedhur si kandidate fituese dhe se kundër kandidatja e saj është pyetur më pak nga anëtarët e komisionit se sa kjo, e njëjta kërkon nga Këshilli që ta aprovon ankesën e saj, ta shfuqizoj Vendimin me Nr.01-58/23 të datës 18.04.2023 nga KVLB dhe të anuloj konkursin për pozitën në fjalë.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkritazi me procedurën e rekrutimit të lartcekur, gjegjësisht Kolegji analizoj:

Nenin 38 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni".

Nenin 38 paragrafin 5 dhe 6, me të cilin është përcaktuar se: "5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës."

Po ashtu Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

Nenin 44 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: "1. Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje"

Neni 45 paragrafit 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: "1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin".

Nenin 47 paragrafin 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: "1. KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2. Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3. KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4. Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike".

Nenin 48 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mblidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2. Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mblidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit".

Nenin 49 paragrafin 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: "1. KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2. Kandidati që është vlerësuar me më shumë pike dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pike është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pike, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues".

Andaj, bazuar në dispozitat e lartcekura, si dhe në mbështetje të nenit 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kolegji ka shqyrtuar ligjshmërinë e procedurës me numër reference RN00010474, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së shpallja e konkursit dhe kërkesat e

përgjithshme për pranim si dhe kërkesat e përgjithshme formale për pozitën e shpallur kanë qenë në pajtim me nenin 8 dhe 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe se procedura e vlerësimit të kandidatëve është bërë në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për vendosje të drejtë dhe meritore Kolegji i Këshillit ka analizuar Konkursin me numër reference RN00010474 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës *Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*, sipas të cilit si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civil të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende dhe të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.* Ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimi i kërkuar:** *Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në fushë të punës Sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose ndenjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, Përvoja e punës së kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale, dhe licenca.* Ndërsa nga analizimi i dokumentacionit, Kolegji ka gjetur se kandidatja . . . e përzgjedhur si kandidatja e suksesshme posedon Certifikatën me Nr.11167/675 të datës 27.02.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 11.01.2012 ka përfunduar studimet themelore në Departamentin e Psikologjisë dhe me këtë rast ka marrë titullin Bachelor i Psikologjisë, po ashtu e njëjta posedon Diplomën me Nr.1582 të datës 24.12.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Filozofik, me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 09.12.2020 ka përfunduar studimet postdiplomike në Departamentin e Psikologjisë-Programi Psikologji Shkollore dhe Këshillim dhe me këtë rast ka marrë titullin Master i Psikologjisë, ndërsa lidhur me përvojën e punës e njëjta ka bashkangjitur: Akt emërimit të datës 23.01.2013 sipas së cilës ka punuar në pozitën si Psikologe në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Ferizajt, Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të datës 11.06.2019 sipas të cilit e njëjta ka punuar në pozitën si Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime Sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Ferizajt si dhe Vendimin me Nr.01-67/21 të datës 15.12.2021 të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Ferizajt sipas të cilit e njëjta është emëruar si Ushtruese e detyrës së Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale. Po ashtu e njëjta bazuar në provat e lëndës e sipas kushteve të parapara të konkursit ka bashkangjitur Vërtetimin e datës 01.11.2022 të lëshuar nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Ferizajt sipas së cilës dëshmohet se nuk ka qenë e ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore të bashkangjitur në dosjen e saj personale dhe se po ashtu ka bashkangjitur edhe Formularët e vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2020 me notë të vlerësimit 5 dhe vitin 2021 me notë të vlerësimit 3.7 .Rrjedhimisht mbi bazën e këtyre fakteve rezultojnë së kandidatja . . .

. . . ka plotësuar kushtet e përgjithshme për lëvizje brenda kategorisë si dhe kushtet e përgjithshme formale për pozitën e shpallur, ndërsa bazuar në vlerësimet e Komisionit të Vlerësimit, e njëjta është vlerësuar me gjithsejtë 94 pikë, duke u renditur si kandidatja me më shumë pikë të fituara, ndërsa ankuesja ka arritur të grumbulloj 88.6 pikë duke u renditur si kandidatja e dytë, andaj mbi këtë bazë, Kolegji konstaton se Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 49 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: "*...2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëm.*"

Lidhur me pretendimin ankimor së është bërë ndryshimi i vendit për zhvillimin e intervistës me gojë dhe se kundër kandidatja e saj në këtë procedurë të rekrutimit është intervistuar më pak se 20 minuta për dallim nga ankuesja e cila pretendon se intervistimi i saj ka zgjatur nga ora 10:22 deri në 11:15, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se këto veprime janë te natyrës teknike dhe si të tilla nuk kanë ndikuar në vlerësimin e tërësishëm dhe përfundimtar të KVLBK-së në raport me kandidaten tani të përzgjedhur si kandidate fituese, ngase bazuar në formularët e pyetjeve të intervistës me gojë të datës 07.04.2023 që të dyja kandidatet janë vlerësuar në mënyrë të barabartë me pyetjet e njëjta të parashtruara nga ana e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, kështu që Kolegji vlerëson së pretendimi ankimor në fjalë nuk ka mbështetje ligjore.

Përkitazi më pretendimin ankimor se anëtarja e Komisionit të Vlerësimit me inicialet E.S ka pasur lidhje familjare me kandidaten e përzgjedhur, ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi nga e cila provohet ekzistimi i konflikti të interesit të pretenduar dhe se ankuesja nuk kishte ofruar ndonjë shkresë se e njëjta gjatë procedurës së vlerësimit kishte parashtruar kërkesë për përjashtim të anëtares për të cilin pretendon se ka pasur konflikt të interesit, kështu që edhe ky pretendim ankimor nuk ka mbështetje në prova materiale dhe ligjore.

Bazuar në konstatimet si me sipër, Kolegji vlerëson se Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Komunën e Ferizajt me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.01-58/23 të datës 18.14.2023, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyratë Publike dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.754/2023

Ardita Perguku-Shyti

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.